Deepak Chopra

Hapat nga A deri në Z
për Krijimin e Begatisë



e përktheu

Ridvan Bunjaku

|:(|:)

Shtator 2010

Hapat nga A deri në Z për Krijimin e Begatisë

(versioni i plotë për studim nga libri)

Cilat janë pra gjendjet e vetëdijes, gjendjet e informatës dhe të energjisë që i japin rritë përjetimit të bollëkut në jetët tona?

Për hir të lehtësisë, dhe për ta bërë më të lehtë mbajtjen në mend, i kam listuar ato në renditje si hapat nga A deri në Z për krijimin e begatisë.

Në përvojën time, nuk është e nevojshme të praktikohen me qëllim qëndrimet që do t'i përshkruaj në mënyrë që të materializohet bollëku. Përdorimi i përpjekjes për ta praktikuar me qëllim një qëndrim apo për ta kultivuar një disponim është i panevojshëm dhe mund të shkaktojë stres dhe sforcim. E rëndësishme është vetëm ta dimë se cilat janë këto qëndrime nga A deri në Z, ta dimë se cilët janë hapat, të jemi **të vetëdijshëm** për ta.

Sa më shumë që vetëdijesohemi për ta, aq më shumë strukturohet kjo dije në ndërgjegjen dhe në vetëdijen tonë. Pastaj është më e mundshme që qëndrimi dhe sjellja jonë do të ndryshojnë spontanisht, pa ndonjë përpjekje nga ana jonë.

Dija ka fuqi organizuese në vetë qenien e vet. Thjesht mjafton t'i dimë, të jemi të vetëdijshëm për principet; dija do të përpunohet dhe do të metabolizohet nga trupat tonë, dhe rezultatet do të jenë spontane. Rezultatet nuk ndodhin brenda natës, por fillojnë të manifestohen gradualisht gjatë një periudhe kohore.

Nëse do ta shikoni këtë listë dhe do ta lexoni një herë në ditë, apo do ta dëgjoni në kasetë çdo ditë, atëherë do t'i shihni ndryshimet që ndodhin spontanisht në jetën tuaj dhe lehtësinë e pamundim me të cilën do të vijë pasuria dhe begatia në jetën tuaj.

A

- **All possibilities (të gjitha mundësitë)**
- **Absolute (absolut)**
- **Authority (autoritet)**
- **Affluence (begati) dhe**
- **Abundance (bollëk)**

'A' është për të gjitha mundësitë, absolut(e), autoritet, begati dhe bollëk. Natyra e vërtetë e gjendjes tonë themelore dhe ajo e universit është se është fushë e të gjitha mundësive. Në formën tonë më themelore, ne jemi fushë e të gjitha mundësive.

Nga ky nivel është e mundur të krijohet gjithçka. Kjo fushë është natyra jonë thelbësore. Është vetja jonë e brendshme.

Po ashtu, ajo quhet absolutja, dhe është autoriteti vendimtar. Brendësisht është begati sepse i jep rritje diversitetit të pafundmë dhe i jep bollëk universit.

B

- **Better (më mirë) dhe**
- **Best (më së miri)**

'B' është për më mirë dhe më së miri. Evolucioni implikon të bëhemi gjithnjë e më mirë në çdo mënyrë me kalimin e kohës, duke e sjellë përfundimisht për neve më të mirën e çdo gjëje.

Njerëzit me vetëdije të begatisë përcaktohen vetëm për më të mirën. Ky quhet edhe principi i të parit më të lartë. Shko me klasë të parë tërë rrugës dhe universi do të përgjigjet duke ta dhënë më të mirën.

C

- **Carefreeness (shkujdesja) dhe**
- **Charity (bamirësia)**

'C' është për shkujdesje dhe bamirësi. Një miliard euro në bankë, pa përjetimin e shkujdesjes dhe të bamirësisë, janë gjendje e varfërisë. Vetëdija e pasur, sipas definicionit, është gjendje e mendjes. Nëse jeni vazhdimisht të shqetësuar se sa para ju nevojiten, atëherë pavarësisht nga sasia aktuale e eurove që i keni në llogarinë tuaj, ju jeni vërtet të varfër.

Shkujdesja çon automatikisht në bamirësi dhe shpërndarje të pasurisë sepse burimi nga i cili vijnë të gjitha është i pafundmë, i pakufizuar dhe i pashtershëm.

D

- **law of Demand and supply**
  (ligji i kërkesës dhe i furnizimit)
- **D'harma**

'D' është ligjin e kërkesës dhe të furnizimit. Për cilindo shërbim qofshim këtu për ta dhënë, ka kërkesë për të. Pyete veten, "si mund të shërbej?" dhe "si mund të ndihmoj?". Përgjigjet janë brenda teje. Kur i gjen këto përgjigje, po ashtu do ta shohësh dhe do ta dish se ka kërkesë për shërbimin tënd.

'D' është edhe për d'harma. Secili nga ne e ka një d'harma, një qëllim në jetë. Kur jemi në d'harma, ne kënaqemi dhe e duam punën tonë.

E

- **Exulting in the success of others**
  (të ngazëllehesh në suksesin e të tjerëve)
- **Expectancy determines outcome**
  (pritja e përcakton rezultatin)

'E' është për ngazëllimin në suksesin e të tjerëve, sidomos të konkurrentëve tu dhe të atyre që e konsiderojnë vetveten si armiqtë e tu. Konkurrentët dhe armiqtë e tu do të bëhen ndihmuesit e tu kur ti ngazëllehesh në suksesin e tyre.

'E' po ashtu është për principin se pritja, shpresa, e përcakton rezultatin. Prandaj gjithmonë prite, shpreso për më të mirën dhe do ta shohësh se rezultati përmbahet spontanisht në atë që e pret, që shpreson.

F

- **the Fact that in every Failure is the seed of success**
  (fakti se në çdo dështim është fara e suksesit)

'F' është për faktin se në çdo dështim është fara e suksesit. Në manifestimin e materiales nga jo-materialja, të të dukshmes nga e padukshmja, është e involvuar një mekanikë fundamentale. Ky është principi i përgjigjes vlerësuese (feedback-ut).

Dështimet tona janë hapat kalues në mekanikën e krijimit, duke na sjellë gjithnjë e më afër qëllimeve tona. Në realitet, nuk ka diçka të tillë që quhet dështim. Ajo që ne e quajmë dështim është thjesht një mekanizëm nëpër të cilin mund të mësojmë t'i bëjmë gjërat si duhet.

G

- **Gratitude (mirënjohje)**
- **Generosity (zemërgjerësi)**
- **God (Zot)**
- **Gap (zbraztësi) dhe**
- **Goal (qëllim)**

'G' është për mirënjohje, zemërgjerësi, Zot, zbraztësi dhe qëllim. Mirënjohja dhe zemërgjerësia janë atribute të natyrshme të një vetëdijeje të begatisë. Meqë gjëja e vetme të cilën duhet ta ndjekim është më e mira, principi i të parit më të lartë, pse të mos e adoptojmë Zotin si model të rolit? Në fund të fundit, askush nuk është më i begatshëm se Zoti, meqë Zoti është fusha e të gjitha mundësive.

Është e rëndësishme të kesh qëllim të qartë në vetëdijen tënde, por po ashtu është e rëndësishme ta braktisësh lidhjen tënde me qëllimin. Dhe qëllimi është në zbraztësi, dhe zbraztësia është në potencialitetin për t'i organizuar dhe orkestruar detalet e nevojshme për ta shkaktuar cilindo rezultat.

Është një mekanizëm preciz përmes të cilit mund të manifestohen të gjitha dëshirat. Këta katër hapa janë si vijon:

- Hapi një: Rrëshqet në zbraztësinë ndërmjet mendimeve. Zbraztësia është dritarja, korridori, vorbulla transformuese përmes të cilës psika personale komunikon me psikën kozmike.
- Hapi dy: Ke synim të qartë për një qëllim të qartë në zbraztësi.
- Hapi tre: E braktis lidhjen tënde me rezultatin, sepse vrapimi pas rezultatit apo lidhja me të e detyron daljen nga zbraztësia.
- Hapi katër: E lejon universin të merret me detalet.

Ndoshta të kujtohet kur je munduar ndonjëherë ta kujtosh një emër, dhe je munduar, e je munduar, por pa sukses. Përfundimisht, e lëshon vetëdijen tënde nga rezultati, dhe pastaj pak më vonë emri shkrep nëpër ekranin e vetëdijes tënde. Kjo është mekanika për plotësimin e çfarëdo dëshire.

Kur ishe duke u munduar ta kujtosh emrin, mendja ishte shumë aktive dhe e trazuar. Por përfundimisht, nga lodhja dhe frustrimi, ti ke heqë dorë dhe mendja është bërë e qetë dhe ngadalë më e qetë - ndoshta aq e qetë sa që ka qenë thuajse e heshtur - dhe ti ke rrëshqitur në zbraztësi ku e ke lëshuar dëshirën tënde, dhe së shpejti ajo të është dhënë në dorë. Ky është kuptimi i vërtetë i "Kërko dhe do të pranosh", apo "Trokit dhe do të të çelet dera."

Një nga mënyrat më të lehta dhe më të pamundimshme të rrëshqitjes në zbraztësi është përmes procesit të meditimit. Dhe ka shumë forma të meditimit dhe të lutjes që mund të na ndihmojnë t'i manifestojmë dëshirat tona nga niveli i zbraztësisë.

H

- **Hapiness (lumturi) dhe**
- **Humanity (njerëzim)**

'H' është për lumturi dhe njerëzim dhe faktin që ne jemi këtu për t'i bërë të gjithë njerëzit me të cilët bimë në kontakt – të lumtur.

Jeta natyrshëm evoluon në drejtimin e lumturisë. Vazhdimisht duhet ta pyesim veten se a do të na bëjë neve, dhe ata përreth nesh, të lumtur, ajo që po e bëjmë. Sepse lumturia është qëllimi përfundimtar. Është qëllimi i të gjitha qëllimeve tjera.

Kur kërkojmë para, apo marrëdhënie të mirë, apo punë të shkëlqyeshme, ajo që e kërkojmë në të vërtetë është lumturia. Gabimi që e bëjmë është se nuk e vendosim lumturinë të parën. Po ta bënim këtë, çdo gjë tjetër do të pasonte.

I

- **the power of unbending Intent or Intention (fuqia e synimit apo e qëllimit të pathyeshëm)**

'I' është për fuqinë e synimit apo të qëllimit të pathyeshëm. Është ta marrësh një vendim të pandryshueshëm nga i cili është e pamundur të kthehesh prapa. Është dedikimi, devotshmëria, për ta pasur në mendje vetëm qëllimin. Është një qëllim i definuar mirë i pa-anuluar nga asnjë dëshirë apo interes tjetër konfliktuoz.

Për ta siguruar pasurinë - apo sa i përket kësaj, çdo gjë në universin fizik - ti duhet ta synosh atë, të marrësh vendim të sulesh me të gjitha forcat. Vendimi është i pandryshueshëm me qëndrueshmërinë e qëllimit, i pa-anuluar nga asgjë. Universi merret me detalet, i organizon dhe i orkestron mundësitë. Ti thjesht duhet të jesh vigjilent ndaj këtyre mundësive.

J

- **it is not necessary to Judge**
  (nuk është e nevojshme të gjykojmë)

'J' është për faktin se nuk është e nevojshme të gjykojmë. Kur e braktisim nevojën tonë për t'i klasifikuar gjërat si të mira apo të këqija, të drejta apo të gabuara, atëherë përjetojmë më shumë qetësi në vetëdijen tonë. Kur e heqim ngarkesën e gjykimit, dialogu ynë i brendshëm fillon të qetësohet dhe pastaj është më lehtë t'i qasemi zbraztësisë.

Prandaj është e rëndësishme të largohemi nga definicionet, emërtimet, përshkrimet, interpretimet, vlerësimet, analizat dhe gjykimi, sepse të gjitha këto e krijojnë turbullirën në dialogun tonë të brendshëm.

K

- **organizing power is inherent in Knowledge**
  (fuqia organizuese është në qenie të dijes)

'K' është për faktin se fuqia organizuese është në qenie të dijes. Dija e cilitdo lloj metabolizohet spontanisht dhe sjell ndryshim në vetëdijen prej nga është e mundur të krijohen realitete të reja.

Për shembull, familjarizimi me dijen në këtë libër do t'i krijojë spontanisht kushtet për pasuri dhe begati.

L

- **Love (dashuri) dhe**
- **Luxury (luks)**

'L' është për dashuri dhe luks. Duaje veten. Duaji klientët e tu. Duaje familjen tënde. Duaji të gjithë. Duaje botën. Nuk ka fuqi më të fortë se dashuria.

Po ashtu, adoptoje luksin si stil të jetës. Luksi është gjendja jonë e natyrshme. Adoptimi i luksit si stil të jetës e vendos parathënien, parakushtet për rrjedhjen e pasurisë.

M

- **Making Money for others and helping others Make Money (të bësh para për të tjerët dhe t'iu ndihmosh të tjerëve të bëjnë para)**
- **Motivate (motivo)**

'M' është për të bërë para për tjerët dhe për t'iu ndihmuar të tjerëve që të bëjnë para. Të ndihmuarit e të tjerëve për të bërë para dhe të ndihmuarit e të tjerëve për t'i plotësuar dëshirat e veta është rrugë e sigurt për ta siguruar se ti do të bësh para për vete si dhe do t'i plotësosh më lehtë dëshirat e tua.

'M' po ashtu është për motivo. Mënyra më e mirë për t'i motivuar njerëzit e tjerë që të të ndihmojnë t'i përmbushësh qëllimet e tua është duke iu ndihmuar atyre që t'i përmbushin qëllimet e veta.

N

- **saying No to Negativity (t'i thuash jo negativitetit)**

'N' është për t'i thënë jo negativitetit. Miku im Wayne Dyer, autori i famshëm, ma ka mësuar një teknikë të thjeshtë për këtë. Sa herë që e ka një mendim negativ ai qetësisht i thotë vetvetes, "Tjetri", dhe vazhdon tutje.

T'i thuash jo negativitetit domethënë edhe të mos jesh përreth njerëzve negativë. Njerëzit negativë ta shterin energjinë. Rrethoje veten me dashuri, ambient rritës e kultivues dhe mos e lejo krijimin e negativitetit në ambientin tënd.

O

- **life is the coexistence of all Opposite values (jeta është bashkë-ekzistencë e të gjitha vlerave të kundërta)**
- **Opportunity (shansi, mundësia) dhe**
- **Open and hOnest communication (komunikimi i hapur dhe i sinqertë)**

'O' është për faktin se jeta është bashkekzistencë e të gjitha vlerave të kundërta. Gëzimi dhe pikëllimi, kënaqësia dhe dhembja, lart dhe poshtë, nxehtë dhe ftohtë, këtu dhe atje, drita dhe terri, lindja dhe vdekja. Tërë përjetimi është me kontrast, dhe njëra vlerë do të ishte e pakuptim pa tjetrën.

Një profet i mençur një herë ka thënë, "Një njeri i lindur i verbër nuk do ta dijë kurrë kuptimin e territ sepse kurrë nuk e ka përjetuar dritën."

Kur ka pajtim të qetë, pranim në vetëdijen tonë të kësaj bashkë-ekzistence të gjallë të të gjitha vlerave të kundërta, atëherë automatikisht ne bëhemi gjithnjë e më jo-gjykues. Mposhtësi dhe i mposhturi shihen si dy pole të qenies së njëjtë. Jo-gjykimi çon në qetësimin e dialogut të brendshëm, dhe kjo i çel portat e kreativitetit.

O është edhe për shansin dhe komunikimin e hapur dhe të sinqertë. Çdo kontakt me secilën qenie njerëzore është shans për rritje dhe për plotësim të dëshirës - personi vetëm duhet të jetë vigjilent për shanset përmes vetëdijes së rritur. Komunikimi i hapur dhe i sinqertë i hap kanalet për t'i realizuar këto shanse.

P

- **Purpose in life (qëllimi në jetë) dhe**
- **Pure Potentiality (potencialiteti i pastër)**

'P' është për qëllimin në jetë dhe për potencialitetin e pastër. Ne jemi këtu për ta përmbushur një qëllim. Është e jona ta gjejmë se çfarë është ai qëllim. Kur ta dimë qëllimin tonë atëherë të diturit e qëllimit çon në të kuptuarit e thellë se ne jemi potencialitet i pastër.

Duhet të jemi në gjendje ta shprehim qëllimin tonë në terma shumë të thjeshta. Për shembull, qëllimi im në jetë është të shëroj, ta bëj të lumtur secilin me të cilin vij në kontakt, dhe të krijoj paqe.

Të diturit e qëllimit tonë i çel portat e fushës së potencialitetit të pastër sepse qenësishëm në dëshirën tonë janë farërat dhe mekanika për përmbushjen e tij. Profeti i Vedave thotë, "Unë jam potenciali i pamatshëm i tërë asaj që ka qenë, që është, dhe që do të jetë, dhe dëshirat e mija janë si farërat e lëna në tokë: ato e presin stinën e duhur dhe pastaj manifestohen spontanisht në lule të bukura dhe në drunj të fuqishëm, në kopshte magjepsëse dhe në pyje madhështore."

Q

- **to Question**
  (të diskutosh, të shqyrtosh, të vësh në pyetje)

'Q' është të diskutosh, të shqyrtosh, të vësh në pyetje: ta shqyrtosh dogmën, ta shqyrtosh ideologjinë, ta shqyrtosh autoritetin e jashtëm. Vetëm përmes shqyrtimit të asaj që njerëzit e marrin si të gatshme përgjithmonë (granted), të asaj që njerëzit e dinë si të vërtetë, ne mund të depërtojmë jashtë hipnozës së kushtëzimit shoqëror.

R

- **Receiving is as necessary as giving**

  (marrja, pranimi është po aq i nevojshëm sa dhënia)

'R' është për faktin se marrja, pranimi është po aq i nevojshëm sa dhënia. Të marrësh me mirësjellje dhe me elegancë është shprehje e dinjitetit të dhënies. Ata që janë të paaftë të marrin në të vërtetë janë të pazotë të japin. Dhënia dhe marrja janë aspekte të ndryshme të rrjedhjes së energjisë në univers.

Nuk është e thënë që dhënia dhe marrja të jenë në formë të gjërave materiale. Ta pranosh me mirësjellje një kompliment apo një admirim apo një respekt e shpreh tërthorazi edhe aftësinë për t'ua dhënë këto të tjerëve. Dhe mungesa e respektit, e elegancës, e sjelljeve të mira, apo e admirimit e krijon një gjendje të varfërisë pavarësisht nga sasia e parave që i ke në bankë.

S

- **Spending (të harxhuarit) dhe**
- **Service (shërbimi)**

'S' është për të harxhuar dhe për të shërbyer. Paraja është si gjaku; duhet të rrjedhë. Krijimi i rezervave dhe kapja pas saj shkakton ngadalësimin e saj. Në mënyrë që të rritet, ajo duhet të rrjedhë. Përndryshe, bllokohet dhe, si gjaku i mpiksur, mund të shkaktojë vetëm dëm.

Paraja është energji e jetës të cilën e shkëmbejmë dhe e përdorim si rezultat i shërbimit të cilin ia ofrojmë universit. Dhe në mënyrë që ajo të vazhdojë të vijë te ne, duhet ta mbajmë në qarkullim.

T

- **Transcendence (transcendencë)**
- **Timeless awareness (vetëdije pa kohë)**
- **Talent bank (grup i talenteve) dhe**
- **Tithing (dhënie për bamirësi)**

'T' është për transcendencë, vetëdije pa kohë, grup të talenteve, dhe dhënie për bamirësi.

Përvoja ime personale është se pa transcendencë, jeta nuk ka bukuri. Në mënyrë që të jetosh jetë të plotë nevojitet të shkosh përtej të gjithë kufijve.

Siç ka thënë poeti sufi Rumi, "Përtej ideve të veprimit të duhur dhe të veprimit të gabuar është një fushë. Shihemi atje." E ndiej se përjetimi im i transcendencës përmes praktikës së meditimit më jep stabilitet të brendshëm dhe qetësi që nuk mbi-hijezohet nga asnjë aktivitet. Ajo qetësi rri me mua ashtu që asnjë përjetim i jashtëm nuk mund ta mbi-hijezojë vetëdijen dhe përjetimin e vetes.

'T' është po ashtu për vetëdije pa kohë, e kundërt me vetëdijen e kufizuar nga koha. Vetëdija e kufizuar nga koha ndodh kur e braktisim veten në shkëmbim të imazhit të vetes. Imazhi i vetes është maska shoqërore, fasada mbrojtëse prapa të cilës fshehemi. Në vetëdijen e kufizuar nga koha sjellja jonë gjithmonë ndikohet nga e kaluara dhe nga parashikimi dhe frika e të ardhmes. Vetëdija e kufizuar nga koha është e ngarkuar me faj dhe pikëllim. Ajo i ka rrënjët në frikë. Ajo e shkakton entropinë, plakjen, dhe vdekjen. Vetëdija e pakohë është vetëdija e vetes.

Profeti i Vedave thotë, "Nuk brengosem për të kaluarën dhe nuk frikësohem për të ardhmen sepse jeta ime është e përqendruar në mënyrë supreme në të tashmen, dhe përgjigjja e duhur më vjen në secilën situatë derisa ngjan ajo." Kjo është po ashtu edhe gjendja e haresë. Vetja nuk është në botën e mendimeve. Ajo është në zbraztësinë ndërmjet mendimeve tona. Psika kozmike na pështpërit butësisht në zbraztësinë ndërmjet mendimeve tona. Kjo është ajo që e quajmë edhe intuitë. Vetëdija e kufizuar nga koha është në intelekt; ajo bën llogaritje. Vetëdija pa kohë është në zemër; ajo ndien.

'T' është edhe për grupin e talenteve. Në mënyrë që të maksimizohet kreativiteti dhe të ofrohet shërbimi më i mirë, është mirë të zhvillohet një grup i talenteve apo një ekip i individëve me talente unike dhe diverse, dhe talentet individuale të të cilëve, kur mblidhen bashkë, janë më shumë se sa shuma e pjesëve.

'T' është edhe për dhënien për bamirësi. Dhënia për bamirësi domethënë ta falësh një pjesë të caktuar të të ardhurave tua pa kushte apo kufizime. Kur jep, krijohet një vakum që tërheq edhe më shumë nga ajo që e ke falur. Siç ka thënë Emersoni, "Pa zemër të pasur, pasuria është një lypës i shëmtuar."

U

- **Understanding the Unity behind all diversity**

  (ta kuptosh unitetin prapa tërë diversitetit)

'U' është për të kuptuarit e unitetit prapa tërë diversitetit. Vetëdija e unitetit është gjendje e ndriçimit të mendjes ku ne e përshkojmë, e depërtojmë maskën e iluzionit që e krijon ndarjen dhe fragmentimin. Prapa pamjes së ndarjes është një fushë e unifikuar e tërësisë. Këtu profeti dhe peisazhi janë një.

Ne e përjetojmë vetëdijen e unitetit kur jemi në dashuri, kur jemi me natyrën duke i vështruar yjet apo duke ecur në plazh, duke dëgjuar muzikë, duke vallëzuar, duke lexuar poezi, duke u lutur, dhe në qetësinë e meditimit.

Në vetëdijen e unitetit, ne rrëshqasim nëpër barrierën e kohës deri te fusha e lojës e eternitetit, sikur kur themi, "Bukuria e malit të linte pa frymë; koha u ndal." Pastaj ti dhe mali bëheni një. Në një nivel shumë të thellë të vetëdijes, e dimë se ti dhe unë dhe mali dhe çdo gjë tjetër është Qenia e njëjtë në maskime të ndryshme.

Kjo është gjendja e dashurisë - jo si sentiment, por si e vërtetë fundamentale, në zemër të tërë krijimit.

V

- **Values (vlerat)**

'V' është për vlerat: e vërteta, drejtësia, ndershmëria, dashuria, besimi, devotshmëria (dedikimi i thellë), dhe bukuria. Poeti i madh indian Rabindranat Tagor thotë, "Kur e ndiejmë bukurinë, e dimë si të vërtetë."

Pa vlera ka konfuzion dhe kaos. Kur vlerat shpërbëhen, çdo gjë shpërbëhet. Shëndeti shpërbëhet, varfëria arrin dominim ndaj begatisë, shoqëritë dhe civilizimet bëhen hi e pluhur.

Kur iu kushtojmë vëmendje këtyre vlerave të cilat shoqëria gjithmonë i ka mbajtur si të shenjta, atëherë rendi shfaqet nga kaosi, dhe fusha e potencialitetit të pastër brenda nesh bëhet e gjithë-fuqishme, duke krijuar gjithçka që dëshiron.

W

- **Wealth consciousness Without Worries (vetëdija e begatisë pa brenga)**

'W' është për vetëdijen e begatisë pa brenga. Vetëdija e begatisë e përfshin mungesën e brengave për para. Njerëzit vërtet të pasur kurrë nuk brengosen për humbjen e parave të veta sepse e dinë se ka furnizim të pashtershëm të tyre.

Një herë, kur ishim duke e diskutuar një projekt të paqes botërore me mësuesin tim, Maharishi Mahesh Yogi, dikush e pyeti atë, "Prej nga do të vijnë të gjitha këto para?" dhe ai u përgjigj pa hezitim, "Prej kudo qofshin në këtë moment."

X

- **eXpressing honest appreciation and thanks to all who help us**
  (shprehja e vlerësimit dhe të falënderimit të sinqertë të gjithë atyre që na ndihmojnë)

'X' është për shprehjen e vlerësimit dhe të falënderimit të sinqertë të gjithë atyre që na ndihmojnë. Kurrë nuk duhet të shtiremi sikur po çmojmë, po vlerësojmë diçka, por nëse e ndiejmë, atëherë duhet ta shprehim atë. Shprehja e mirënjohjes është forcë e fuqishme që gjeneron edhe më shumë nga ajo që tashmë e kemi pranuar.

Y

- **Youthful vigor (gjallëria rinore)**

'Y' është për gjallërinë rinore. Ne përjetojmë shëndet kur identiteti ynë, se kush jemi ne, vjen nga referimi te vetja. Kur identifikohemi me objektet, qofshin ato situata, rrethana, njerëz, apo gjëra, atëherë ia lëshojmë energjinë tonë objektit të referencës. Si rezultat, ndiejmë mungesë të energjisë dhe të vitalitetit.

Kur identiteti ynë vjen nga vetja, atëherë e mbajmë energjinë tonë për vete. Ndihemi energjikë, ndihemi të fuqishëm, dhe përjetojmë gjallëri rinore.

Z

- **Zest for life (lezeti për jetë)**

'Z' është për lezetin për jetë. Është ta çmosh jetën në tërë vitalitetin dhe bollëkun e saj. Është ta dish se është vetëm një jetë që e shpreh veten në forma të panumërta. Ta shohësh atë jetë është ta dish se fuqia është në momentin e tashëm. Është ta dish se unë jam ajo, se ti je ajo, se tërë kjo është ajo, dhe se ajo është e tëra që është.

Tagor një herë ka thënë, "Vrushkulli i njëjtë i jetës, që kalon nëpër botë, kalon përmes venave të mija natë e ditë dhe vallëzon me ritëm. Është e njëjta jetë që çel në gëzim përmes dheut të tokës nëpër fije të panumërta të barit dhe depërton në valët e trazuara të luleve." Ai e quan këtë "pulsimin jetësor të epokave, që vallëzon në gjakun tim në këtë moment." Të jesh në kontakt me këtë pulsim jetësor të epokave që vallëzon në gjakun tonë në këtë moment është të kesh lezet për jetë. Është të përballesh me të panjohurën shkujdesshëm dhe lirshëm.

E panjohura është fusha e të gjitha mundësive në çdo moment të të tashmes. Dhe kjo është liria, përtej njohjes së kushtëzimit të të kaluarës, përtej burgut të hapësirës, të kohës dhe të shkaqeve.

Siç i ka thënë Don Juan një herë Carlos Castaneda-s, "Nuk ka rëndësi se çfarë është fati ynë specifik, përderisa i përballemi tërësisht me shkujdesje." Kjo është pabrengshmëri. Ky është gëzim. Kjo është liri. Ky është lezet për jetë.

Pra ja ku je. Këta janë hapat kapërcyes deri te begatia e pakufizuar, A-deri-në-Z e prosperitetit, e mirëqenies. Edhe një herë, nuk ke nevojë që të kultivosh me qëllim disponim të këtyre atributeve. Vetëm duhet të jesh i vetëdijshëm për to.

Lexoje listën përditë, apo thjesht dëgjoje kasetën, dhe do ta shohësh jetën tënde duke ndryshuar dhe duke u bërë shprehje e begatisë, e pakufizueshmërisë, e bollëkut, e pafundësisë, dhe e pavdekshmërisë.

Krijo bollëk aq sa të dëshirojë zemra jote. Plotësoje secilën dëshirë materiale dhe jo-materiale. Krijo bollëk dhe harxhoje. Harxhoje me zemërgjerësi dhe pastaj shpërndaje dhe jepua të tjerëve. Jepua fëmijëve tu, familjes tënde, të afërmve tu, miqve tu, shoqërisë, dhe botës. Sepse bollëku është i universit dhe nuk na takon neve - ne i takojmë atij.

Ne jemi fëmijë të privilegjuar dhe universi ka zgjedhur që ta ndajë bujarinë e tij me ne. Ne vetëm duhet t'ia kushtojmë vëmendjen begatisë dhe ajo do të jetë e jona. Krejt çka është e rëndësishme është vëmendja.

Një profet i madh nga India një herë ka thënë, "Ti je aty ku të çon vëmendja jote. Në fakt, ti je vëmendja jote. Nëse vëmendja jote është e ndarë në copa, ti je i (e) ndarë në copa. Kur vëmendja jote është në të kaluarën, ti je në të kaluarën. Kur vëmendja jote është në momentin e tanishëm, ti je në prezencën e Zotit dhe Zoti është prezent në ty."

Thjesht ji i vetëdijshëm për të tashmen, për atë se çka je duke bërë. Prezenca e Zotit është gjithkund, dhe ti vetëm duhesh ta përqafosh vetëdijshëm me vëmendjen tënde.

Hapat nga A deri në Z për Krijimin e Begatisë

(versioni i shkurtuar për lexim apo dëgjim të përditshëm)

Cilat janë pra gjendjet e vetëdijes, gjendjet e informatës dhe të energjisë që i japin rritë përjetimit të bollëkut në jetët tona?

Për hir të lehtësisë, dhe për ta bërë më të lehtë mbajtjen në mend, i kam listuar ato në renditje si hapat nga A deri në Z për krijimin e begatisë.

Në përvojën time, në mënyrë që të materializohet bollëku, nuk është e nevojshme të praktikohen me qëllim qëndrimet që do t'i përshkruaj. Përdorimi i përpjekjes për ta praktikuar me qëllim një qëndrim, apo për ta kultivuar një disponim, është i panevojshëm, dhe mund të shkaktojë stres dhe sforcim. E rëndësishme është vetëm që ta dimë se cilat janë këto qëndrime nga A deri në Z, ta dimë se cilët janë hapat, të jemi të vetëdijshëm për ta.

Sa më shumë që vetëdijesohemi për ta, aq më shumë strukturohet kjo dije në ndërgjegjen dhe në vetëdijen tonë. Dhe pastaj është më e mundshme që qëndrimi dhe sjellja jonë do të ndryshojnë spontanisht, pa ndonjë përpjekje nga ana jonë.

Dija ka fuqi organizuese në vetë qenien e vet. Thjesht mjafton t'i dimë, të jemi të vetëdijshëm për principet; dija do të përpunohet dhe do të metabolizohet nga trupat tonë, dhe rezultatet do të jenë spontane. Rezultatet nuk ndodhin brenda natës, por fillojnë të manifestohen gradualisht gjatë një periudhe kohore.

Pra le të fillojmë me hapat A-deri-në-Z. Edhe një herë, mjafton ta shikosh këtë listë dhe ta lexosh një herë në ditë, apo edhe më mirë, thjesht dëgjoje kasetën çdo ditë dhe pastaj thjesht shihi ndryshimet spontanisht në jetën tënde dhe lehtësinë e pamundim me të cilën do të vijë pasuria dhe begatia në jetën tuaj.

Pra le të fillojmë.

Hapi 'A'. 'A' është për të gjitha mundësitë, autoritet, absolute, begati, bollëk. Natyra e vërtetë e gjendjes tonë themelore dhe ajo e universit është se është fushë e të gjitha mundësive. Në formën tonë më themelore, ne jemi fushë e të gjitha mundësive.

Nga ky nivel është e mundur të krijohet gjithçka. Kjo fushë është natyra jonë thelbësore. Është vetja jonë e brendshme.

Po ashtu, ajo quhet absolutja, dhe është autoriteti vendimtar. Brendësisht është begati sepse i jep rritje diversitetit të pafundmë dhe bollëkut të universit.

'B' është për më mirë dhe më së miri. Evolucioni implikon të bëhemi gjithnjë e më mirë në çdo mënyrë me kalimin e kohës, duke e sjellë përfundimisht për neve më të mirën e çdo gjëje.

Njerëzit me vetëdije të begatisë përcaktohen vetëm për më të mirën, i quajtur edhe principi i të parit më të lartë. Shko me klas të parë tërë rrugës dhe universi përgjigjet duke ta dhënë më të mirën.

'C' është për shkujdesje dhe bamirësi. Një miliard euro në bankë, pa përjetimin e shkujdesjes dhe të bamirësisë, është gjendje e pabegatisë. Vetëdija e pasur, sipas definicionit, është gjendje e mendjes. Nëse jeni vazhdimisht të paqetë se sa para ju nevojiten, atëherë pavarësisht nga sasia aktuale e eurove që i keni në llogarinë tuaj, ju nuk jeni vërtet të pasur.

Shkujdesja automatikisht çon në bamirësi dhe shpërndarje të pasurisë sepse burimi nga i cili vijnë të gjitha është i pafundmë, i pakufizuar dhe i pashtershëm.

'D' është ligjin e kërkesës dhe të furnizimit. 'D' është edhe për d'harma. Secili nga ne e ka një d'harma, një qëllim në jetë. Kur jemi në d'harma, ne kënaqemi dhe e duam punën tonë. Për cilindo shërbim qofshim këtu për ta dhënë, ka kërkesë për të. Krijoje dhe parashikoje atë kërkesë për të cilën ke ardhur këtu, dhe ofroje atë kërkesë, dhe furnizimi është i garantuar.

'E' është për ngazëllimin në suksesin e të tjerëve, sidomos të konkurrentëve tu dhe të atyre që e konsiderojnë vetveten si armiqtë e tu.

'F' është për faktin se në çdo mossukses është fara e suksesit.

'G' është për mirënjohje, zemërgjerësi, Zot, qëllim dhe zbraztësi. Mirënjohja dhe zemërgjerësia janë atribute të natyrshme të një vetëdijeje të begatisë. Meqë gjëja e vetme të cilën duhet ta ndjekim është më e mira, principi i të parit më të lartë, pse të mos e adoptojmë Zotin si

modelin e rolit? Në fund të fundit, askush nuk është më i begatshëm se Zoti. E Zoti? Zoti është fusha e të gjitha mundësive.

Është e rëndësishme të kesh qëllim të qartë në vetëdijen tënde, por po ashtu është e rëndësishme ta braktisësh lidhjen tënde me qëllimin. Dhe qëllimi është në zbraztësi, dhe zbraztësia është potencialiteti për t'i organizuar dhe orkestruar detalet e nevojshme për ta shkaktuar cilindo rezultat.

Është një mekanizëm preciz përmes të cilit mund të manifestohen të gjitha dëshirat. Këta katër hapa janë si vijon:

Hapi një: Rrëshqet në zbraztësinë ndërmjet mendimeve. Zbraztësia është dritarja, korridori, vorbulla transformuese përmes të cilës psika personale komunikon me psikën kozmike.

Dy: Ke synim të qartë për një qëllim të qartë në zbraztësi.

Tre: E braktis lidhjen tënde me rezultatin, sepse vrapimi pas rezultatit apo lidhja me të e detyron daljen nga zbraztësia.

Dhe katër: E lejon universin të merret me detalet.

Ndoshta të kujtohet kur je munduar ndonjëherë ta kujtosh një emër, dhe je munduar, e je munduar, por pa sukses. Përfundimisht, e lëshon vetëdijen tënde nga rezultati, dhe pastaj pak më vonë emri shkrep nëpër ekranin e vetëdijes tënde. Kjo është mekanika për plotësimin e çfarëdo dëshire.

Kur ishe duke u munduar ta kujtosh emrin, mendja ishte shumë aktive dhe e trazuar. Por përfundimisht, nga lodhja dhe frustrimi, ti ke heqë dorë dhe mendja është bërë e qetë dhe, ngadalë, më e qetë, dhe ndoshta aq e qetë sa që ka qenë thuajse e heshtur - dhe ti ke rrëshqitur në zbraztësi, ku e ke lëshuar dëshirën tënde, dhe së shpejti, ajo të është dhënë në dorë. Ky është kuptimi i vërtetë i "Kërko dhe do të pranosh", apo "Trokit në derë, dhe do të hysh."

Një nga mënyrat më të lehta dhe më të pamundimshme të rrëshqitjes në zbraztësi është përmes procesit të meditimit transcendental. Dhe ka shumë forma të meditimit dhe të lutjes që mund të na ndihmojnë t'i manifestojmë dëshirat tona nga niveli i zbraztësisë.

'H' është për lumturi dhe njerëzim dhe faktin që ne jemi këtu për t'i bërë të gjithë njerëzit me të cilët bimë në kontakt – të lumtur.

'I' është për fuqinë e synimit apo të qëllimit të pathyeshëm. Është ta marrësh një vendim të pandryshueshëm nga i cili është e pamundur të kthehesh prapa. Është vendosmëria e qëllimit. Është një qëllim i definuar mirë i pa-anuluar nga asnjë dëshirë apo interes tjetër konfliktuoz.

Për ta siguruar pasurinë - apo sa i përket kësaj, çdo gjë në universin fizik - ti duhet ta synosh atë, të marrësh vendim ta ndjekësh me vendosmëri. Vendimi është i pandryshueshëm me qëndrueshmërinë e qëllimit, i pa-anuluar nga asgjë. Universi merret me detalet, i organizon dhe i orkestron mundësitë. Ti thjesht duhet të jesh vigjilent ndaj këtyre mundësive.

'J' është për faktin se nuk është e nevojshme të gjykojmë. Kur e braktisim nevojën tonë për t'i klasifikuar gjërat si të mira apo të këqija, të drejta apo të gabuara, atëherë përjetojmë më shumë qetësi në vetëdijen tonë. Dialogu ynë i brendshëm fillon të qetësohet kur e heqim ngarkesën e gjykimit, dhe pastaj është më lehtë t'i qasemi zbraztësisë.

Është e rëndësishme, prandaj, të largohemi nga definicionet, emërtimet, përshkrimet, interpretimet, vlerësimet, analizat dhe gjykimi, të cilat të gjitha e krijojnë turbullirën e dialogut tonë të brendshëm.

'K' është për faktin se fuqia organizuese është në qenie të dijes. Dija e cilitdo lloj metabolizohet spontanisht dhe sjell ndryshim në vetëdijen prej nga është e mundur të krijohen realitete të reja.

Për shembull, familjarizimi me dijen në këtë kasetë spontanisht do t'i krijojë kushtet për pasuri dhe begati.

'L' është për dashuri dhe luks. Duaje veten. Duaje klientin tënd. Duaje audiencën tënde. Duaji të gjithë. Duaje botën. Nuk ka fuqi më të fortë se dashuria.

Po ashtu, adoptoje luksin si stil të jetës. Luksi është gjendja jonë e natyrshme. Adoptimi i luksit si stil të jetës e vendos parathënien, parakushtet për rrjedhjen e pasurisë.

'M' është për të bërë para për tjerët, për t'iu ndihmuar të tjerëve që të bëjnë para. Të ndihmuarit e të tjerëve për të bërë para dhe të ndihmuarit e njerëzve tjerë për t'i plotësuar dëshirat e veta është rrugë e sigurt për ta siguruar se ti do të bësh para për vete si dhe se do t'i plotësosh më lehtë dëshirat e tua.

'N' është për t'i thënë jo negativitetit.

'O' është për faktin se jeta është bashkekzistencë e të gjitha vlerave të kundërta. Gëzimi dhe pikëllimi, kënaqësia dhe dhembja, lart dhe poshtë, nxehtë dhe ftohtë, këtu dhe atje, drita dhe terri, lindja dhe vdekja. Tërë përjetimi është me kontrast, dhe njëra do të ishte e pakuptim pa tjetrën.

Një profet i mençur një herë ka thënë, "Një njeri i lindur i verbër nuk do ta dijë kurrë kuptimin e territ sepse kurrë nuk e ka përjetuar dritën."

Kur ka pajtim të qetë dhe pranim në vetëdijen tonë të kësaj bashkë-ekzistence të gjallë të të gjitha vlerave të kundërta, atëherë automatikisht ne bëhemi gjithnjë e më jo-gjykues. Mposhtësi dhe i mposhturi shihen si dy pole të qenies së njëjtë. Jo-gjykimi çon në qetësimin e dialogut të brendshëm, duke i çelur edhe një herë portat e kreativitetit.

O është edhe për shansin dhe komunikimin e hapur dhe të sinqertë. Çdo kontakt me secilën qenie njerëzore është shans për rritje dhe për plotësim të dëshirës – vetëm se personi duhet të jetë vigjilent për shanset përmes vetëdijes së rritur. Komunikimi i hapur dhe i sinqertë i hap kanalet për t'i realizuar këto shanse.

'P' është për qëllimin në jetë dhe për potencialitetin e pastër. Ne jemi këtu për ta përmbushur një qëllim. Është e jona ta gjejmë se çfarë është ai qëllim. Posa ta dimë qëllimin tonë atëherë të diturit e qëllimit çon në të kuptuarit e thellë se ne jemi potencialitet i vërtetë.

Duhet të jemi në gjendje ta shprehim qëllimin tonë shumë thjesht në terma të thjeshta. Për shembull, qëllimi im në jetë është të shëroj, ta bëj secilin me të cilin vij në kontakt - të lumtur, dhe të krijoj paqe. Dhe pastaj të diturit e atij qëllimi i çel portat e fushës së potencialitetit të pastër. Profeti i Vedave thotë, "Unë jam potenciali i pamatshëm i tërë asaj që ka qenë, që është, dhe që do të jetë, dhe dëshirat e mija janë si farërat e lëna në tokë: ato e presin stinën e duhur dhe pastaj manifestohen spontanisht në lule të bukura dhe në drunj të fuqishëm, në kopshte magjepsëse dhe në pyje madhështore." Qenësishëm në të pasurit e dëshirës është fara dhe mekanika për përmbushjen e saj.

'Q' është të shqyrtosh: ta shqyrtosh dogmën, ta shqyrtosh ideologjinë, ta shqyrtosh autoritetin e jashtëm. Vetëm përmes shqyrtimit të asaj që njerëzit e marrin si të gatshme përgjithmonë, të asaj që njerëzit e mbajnë si të vërtetë, ne mund të depërtojmë jashtë hipnozës së kushtëzimit shoqëror.

'R' është për faktin se marrja, pranimi është po aq i nevojshëm sa dhënia. Të marrësh me mirësjellje dhe me elegancë është shprehje e dinjitetit të dhënies.

'S' është për të harxhuar dhe për të shërbyer. Paraja është si gjaku; duhet të rrjedhë. Krijimi i rezervave dhe kapja pas saj shkakton ngadalësimin e saj. Në mënyrë që të rritet, ajo duhet të rrjedhë. Përndryshe, bllokohet dhe, si gjaku i mpiksur, mund të shkaktojë vetëm dëm.

Paraja është energji e jetës të cilën e shkëmbejmë dhe e përdorim si rezultat i shërbimit të cilin ia ofrojmë universit. Dhe në mënyrë që ajo të vazhdojë të vijë te ne, duhet ta mbajmë në qarkullim.

'T' është për transcendencë, për vetëdije pa kohë, për grup të talenteve, dhe dhënie për bamirësi.

Përvoja ime personale është se pa transcendencë, jeta nuk ka bukuri. Në mënyrë që të jetosh jetë të plotë nevojitet të shkosh përtej të gjithë kufijve.

Siç ka thënë poeti sufi Rumi, "Përtej ideve të veprimit të duhur dhe të veprimit të gabuar është një fushë. Shihemi atje." E ndiej se përjetimi im i transcendencës përmes praktikës së meditimit më jep stabilitet dhe qetësi të brendshme që nuk mbi-hijezohet nga asnjë aktivitet. Ajo qetësi rri me mua ashtu që asnjë përjetim i jashtëm nuk mund ta mbi-hijezojë vetëdijen dhe përjetimin e vetes.

'T' është po ashtu për vetëdije pa kohë, e kundërt me vetëdijen e kufizuar nga koha. Vetëdija e kufizuar nga koha ndodh kur e braktisim veten në shkëmbim të imazhit të vetes. Imazhi i vetes është maska shoqërore, fasada mbrojtëse prapa të cilës fshehemi. Në vetëdijen e kufizuar nga koha sjellja jonë gjithmonë ndikohet nga e kaluara dhe nga parashikimi dhe frika e të ardhmes. Vetëdija e kufizuar nga koha është e ngarkuar me faj dhe pikëllim. Ajo i ka rrënjët në frikë. Ajo e shkakton entropinë, plakjen, dhe vdekjen. Vetëdija e pakohë është vetëdija e vetes.

Profeti i Vedave thotë, "Nuk brengosem për të kaluarën dhe nuk frikësohem për të ardhmen sepse jeta ime është e përqendruar në mënyrë supreme në të tashmen, dhe përgjigjja e duhur më vjen në secilën situatë derisa ngjan ajo." Kjo është po ashtu edhe gjendja e haresë. Vetja nuk është në botën e mendimeve. Ajo është në zbraztësinë ndërmjet mendimeve tona. Psika kozmike na pëshpërit butësisht në zbraztësinë ndërmjet mendimeve tona. Kjo është ajo që e quajmë edhe

intuitë. Vetëdija e kufizuar nga koha është në intelekt; ajo bën llogaritje. Vetëdija pa kohë është në zemër; ajo ndien.

'T' është edhe për grupin e talenteve. Në mënyrë që të maksimizohet kreativiteti dhe të ofrohet shërbimi më i mirë, është mirë të zhvillohet një grup i talenteve apo një ekip i individëve me talente e aftësi unike dhe diverse, dhe talentet individuale të të cilëve, kur mblidhen bashkë, janë më shumë se sa shuma e pjesëve.

'T' është edhe për dhënien për bamirësi. Dhënia për bamirësi domethënë ta falësh një pjesë të caktuar të të ardhurave tua pa kushte apo kufizime. Kur jep, krijohet një vakum që tërheq edhe më shumë nga ajo që e ke falur.

'U' është për të kuptuarit e unitetit prapa tërë diversitetit.

'V' është për vlerat: e vërteta, drejtësia, ndershmëria, dashuria, besimi, devotshmëria dhe bukuria. Tagor thotë, "Kur e ndiejmë bukurinë, e dimë si të vërtetë."

'W' është për vetëdijen e begatisë pa brenga. Vetëdija e begatisë e përfshin mungesën e brengave për para. Njerëzit vërtet të pasur kurrë nuk brengosen për humbjen e parave të veta sepse e dinë se prej kudoardhshin paratë, ka furnizim të pashtershëm të tyre.

Një herë, kur ishim duke e diskutuar një projekt të paqes botërore me mësuesin tim, Maharishi Mahesh Yogi, dikush e pyeti atë, "Prej nga do të vijnë të gjitha këto para?" dhe ai u përgjigj pa hezitim, "Prej kudo qofshin në këtë moment!"

'X' është për shprehjen e vlerësimit dhe të falënderimit të sinqertë të gjithë atyre që na ndihmojnë.

'Y' është për gjallërinë rinore. Ne përjetojmë shëndet kur identiteti ynë, se kush jemi ne, vjen nga referimi te vetja. Kur jemi të referuar te objektet, domethënë identifikohemi me objektet, qofshin ato situata, rrethana, njerëz, apo gjëra, atëherë ia lëshojmë energjinë tonë objektit të referencës. Si rezultat, ndiejmë mungesë të energjisë dhe të vitalitetit.

Kur identiteti ynë vjen nga vetja, atëherë e mbajmë energjinë tonë për vete. Ndihemi energjikë, ndihemi të fuqishëm, dhe përjetojmë gjallëri rinore.

Z është për lezetin për jetë. Është ta çmosh jetën në tërë vitalitetin dhe bollëkun e saj. Është ta dish se është vetëm një jetë që e shpreh veten në forma të panumërta. Është ta dish se unë jam ajo, se ti je ajo, se tërë kjo është ajo, dhe se ajo është e tëra që është. Ta shohësh atë jetë është ta dish se fuqia është në momentin e tashëm.

Poeti i madh indian Tagor një herë ka thënë, "Vrushkulli i njëjtë i jetës, që kalon nëpër botë, kalon përmes venave të mija natë e ditë, dhe vallëzon me mënyrë ritmike. Është e njëjta jetë që çel në gëzim përmes dheut të tokës nëpër fije të panumërta të barit dhe depërton në valët e trazuara të luleve." Ai e quan këtë "pulsimin jetësor të epokave, që vallëzon në gjakun tim në këtë moment." Të jesh në kontakt me këtë pulsim jetësor të epokave, që vallëzon në gjakun tonë në këtë moment është të kesh lezet për jetë. Është të përballesh me të panjohurën shkujdesshëm dhe lirshëm.

E panjohura është fusha e të gjitha mundësive në çdo moment të të tashmes. Dhe kjo është liria, përtej njohjes së kushtëzimit të kaluar, përtej burgut të hapësirës, të kohës dhe të shkaqeve.

Siç i ka thënë Don Juan një herë Carlos Castaneda-s, "Nuk ka rëndësi se çfarë është fati ynë specifik, përderisa i përballemi tërësisht me shkujdesje." Kjo është pabrengshmëri. Ky është gëzim. Kjo është liri. Ky është lezet për jetë.

Pra, ja ku je. Këta janë hapat kapërcyes deri te begatia e pakufizuar, A-deri-në-Z e prosperitetit. Edhe një herë, nuk ke nevojë që të kultivosh me qëllim disponim të këtyre atributeve. Duhet vetëm të jesh i vetëdijshëm për to.

Lexoje listën përditë, apo edhe më mirë, thjesht dëgjoje kasetën, dhe shihe jetën tënde duke ndryshuar dhe duke u bërë shprehje e begatisë, e pakufizueshmërisë, e bollëkut, e pafundësisë, dhe e pavdekshmërisë.

Krijo bollëk aq sa të dëshirojë zemra jote. Plotësoje secilën dëshirë materiale dhe jo-materiale. Krijo bollëk dhe harxhoje. Harxhoje me zemërgjerësi dhe pastaj shpërndaje dhe jepua të tjerëve. Jepua fëmijëve tu, familjes tënde, të afërmve tu, miqve tu, shoqërisë, dhe botës. Sepse bollëku është i universit dhe nuk na takon neve - ne i takojmë atij. Ne jemi fëmijë të privilegjuar dhe universi ka zgjedhur që ta ndajë bujarinë e tij me ne. Ne vetëm duhet t'ia kushtojmë vëmendjen begatisë dhe ajo do të jetë e jona. Vëmendja është krejt çka ka rëndësi.

Një profet i madh nga India një herë ka thënë, "Ti je aty ku të çon vëmendja jote. Në fakt, ti je vëmendja jote. Nëse vëmendja jote është e fragmentuar, ti je fragmentuar. Kur vëmendja jote është në të kaluarën,

ti je në të kaluarën. Kur vëmendja jote është në momentin e tanishëm, ti je në prezencën e Zotit dhe Zoti është prezent në ty.”

Thjesht ji i vetëdijshëm për të tashmen, për atë se çka je duke bërë. Prezenca e Zotit është gjithkund, dhe ti vetëm duhesh ta përqafosh vetëdijshëm me vëmendjen tënde.

Ky libër mund të gjendet online në faqet:

http://sa-kra.ch/

http://www.syri3.com/

Faqja në Facebook: |:(|:) Publikimet RB

http://sites.google.com/site/kalabuli/

Përkthyesi i falënderon autorët e ueb-faqeve

për kontributin në shpërndarjen e dijes